





PLANI (Bazik)
OPERATIV EMERGJENT
për
Komunën e Gjiçanit

Maj 2022
Gjiçan

PËRMBAJTJA

Prezantimi i Planit Operativ Emergjent (nga Kryetari i Komunës)	4
Deklarata e shpalljes së Planit Operativ Emergjent	5
Hyrje (plani bazik)	6
Plani Operativ (i Reagimit) Emergjent për Mbrojtje Shpëtim dhe	
Ndihmë nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga Fatkeqësitë e Tjera	6
Procesi i hartimit të POE për MSHN nga FN & FT-a	8
I. QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI, SITUATA DHE SUPOZIMET	9
1.1 Qëllimi i POE	9
1.2 Fushëveprimi	9
1.3 Situata	9
1.4 Supozimet	10
II. KONCEPTI I VEPRIMIT/OPERIMIT	12
2.1 I përgjithshëm	12
2.2 Fazat e menaxhimit	12
III. ORGANIZIMI DHE CAKTIMI I PËRGJEGJËSIVE	14
3.1 I përgjithshëm	14
3.2 Organizmi	14
3.2.1 Grupi i politikave	14
3.2.2 Grupi koordunues	15
3.2.3 Sektori Operativ i Menaxhimit Emergjent	15
3.3 Caktimi i përgjegjësive	16
- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH)	16
- Zbatimi i ligjit - Policia e Kosovës (PK)	17
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS)	17
- Drejtoria e Shërbimeve Publike (DSHP)	18
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa (DBF)	19
- Drejtoria e Arsimit (DA)	19
- Zyra e mjekut ligjor	19
- Prokurori	19

- Kryqi i Kuq i Kosovës dega në Gjilan	19
- Kompania e telefonisë	20
- Teknologjia informative	20
- KEDS	20
- Mbështetja e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK)	20
IV. DREJTIMI DHE KONTROLLI	21
V. VIJIMËSIA E QEVERISJES	22
A - Radha e komandës	22
B - Ruajtja e të dhënave (dokumentet)	22
VI. ADMINISTRIMI DHE LOGJISTIKA	23
A - Autoriteti emeergjent	23
B - Procedurat e shpalljes.....	23
C - Ndihma reciproke	23
D - mbrojtja e Konsumatorit	23
VII. OPERACIONET E EVAKUIMIT	24
VIII. QENDRA E INFORMIMIT PUBLIK	25
IX. PËRFUNDIMI I FATKEQËSISË	26
X. HARTMIMI DHE MIRËMBATJA E PLANIT	26
XI. SKEMA ORGANIZATIVE E QENDËRS OPERTAIVE	
EMERGJNETE TË KOMUNËS SË GJILANIT	27

Prezantimi i Planit Operativ Emergjent nga Kryetari i Komunës

Qytetarë të Komunës së Gjilanit kam nderin që para jush të prezantojë Planin Operativ Emergjent (POE) për komunën e Gjilanit, i cili do të jetë një dokument i rëndësishëm në qartësimin e roleve dhe përgjegjësi të të gjitha institucioneve-agjencioneve pjesëmarrëse, strukturave shtetërore dhe shoqërisë civile, nëpërmjet këtij plani kryesisht synohet që:

- ✓ Të parandalohet, lehtësohet dhe të riaftësohet nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgimin kulturore dhe mjedisin nga fatkeqësitë,
- ✓ Të sigurohen kushtet për institucionet komunale, publike dhe private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për komunitetin, ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgimin kulturore dhe për mjedisin, ndaj efekteve të një fatkeqësie natyrore apo fatkeqësie tjetër.
- ✓ Të garantohet përdorimi i të gjitha burimeve të mundshme të shtetit me qëllim të sigurimit publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.

Gjithsesi me këtë plan synohet të krijohen rrugët e komunikimit dhe të shkëmbimit të informacionit të duhur, forcimit të vendimmarrjes dhe nëpërmjet bashkërendimit, arrihet forcimi i kapaciteteve të përgjigjes në të gjitha fazat e ciklit të zhvillimit të emergjencës.

Ky plan do të shërben si kornizë për parandalim, gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike dhe fatkeqësitë e shkaktuara nga faktori njeri, të cilat do mund ta godasin komunën tonë. Unë i garantoj mbështetje të plotë administratës time, profesionistëve të sigurisë publike dhe partnerëve të cilët janë ngarkuar me misionet jetike të përvijuara në këtë plan.

Unë i inkurajoj qytetarët të cilëve ne u shërbejmë që të familjarizohen me rolet e tyre të rëndësishme të reagimit ndaj çdo rreziku i cili mund ta prek komunitetin tonë. Së bashku, duke punuar si një ekip, i përkushtuar për një të ardhme sa më të mirë dhe për sigurinë të gjithë komunitetit tonë pa dallim etnie dhe feje, ne do të jemi të përkushtuar edhe në rimëkëmbje në mënyrë të sigurt nga çdo ngjarje e cila mund ta kërcënoj atë që kemi ndërtuar.

Unë besoj që duke punuar së bashku për ndërtimin e një të ardhme më të fortë për komunitetin tonë, ne do t'ia dalim sfidës për ofrimin e jetës më të sigurt, më kualitative dhe më të qëndrueshme për gjeneratat e ardhshme.

Alban HYSENI

DEKLARATA E SHPALLJES SË

Planit Operativ Emergjent për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga Fatkeqësitë e Tjera për Komunën e Gjilanit.

Në këtë mënyrë shpallim këtë Plan Operativ Emergjent për MSHN nga FN & FT e Komunës së Gjilanit. Ky plan zëvendëson çdo plan ekzistues emergjent të shpallur për këtë qëllim. Njëherit Plani ofron kornizë në të cilën komuna dhe subjektet e saj mund t'i zbatojnë funksionet e tyre përkatëse gjatë fatkeqësisë apo kërcënimit të sigurisë kombëtare.

Ky plan është në harmoni të plotë me Kushtetutën e RK, ligjet, aktet dhe nën aktet në fuqi. Po ashtu është punuar në bashkëveprim me Administratën e Komunës së Gjilanit, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe të shoqërisë civile (OJQ-ve), institucioneve, organizatave vullnetare dhe publikut të gjerë. Plani do të rishikohet dhe ri-certifikohet për çdo vit nga drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim. Të gjithë pranuesit e këtij Plani janë të obliguar ta udhëzojnë drejtorin për mbrojtje dhe shpëtim për çdo ndryshim që mund të rezultojë në nevojën për përmirësim apo tejkalim të nevojës së ekzistimit të mëtutjeshëm.

Datë: _____

Kryetari i Komunës



HYRJE (PLANI BAZIK)

Plani Operativ (i Reagimit) Emergjent për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga Fatkeqësitë e Tjera" [PO(R)E MSHN nga FN & FT].

Në kushtet kur ekziston një bazë ligjore, një strukturë në ngritje dhe përmirësim dhe ku burimet komunale - shtetërore janë të kufizuara, planifikim i përdorimit të kapaciteteve, ndarja mirë e përgjegjësi, identifikimi i boshllëqeve dhe shmangia e mbivendosjeve është mjaft e nevojshme. Këto kërkesa bëhen realitet nëpërmjet POE për MSHN nga FN & FT-a, i cili ofron mundësi për menaxhim efektiv të strukturave shtetërore-komunale dhe atyre jo shtetërore për përballimin e fatkeqësive natyrore-emergjencave të ndryshme civile. POE për MSHN nga FN & FT -a duhet të shihet si dokument praktik, i hartuar nëpërmjet një procesi të gjatë konsultimesh dhe planifikimi të përbashkët me një numër të gjerë institucioneve qeveritare dhe joqeveritare, për ta mbajtur planin koherent dhe të freskuar me informacion të ri në mënyrë të vazhdueshme, aktual e të lidhur me ndryshimet e mjedisit, për të arritur qëllimin për të cilin është hartuar: mbrojtjen e popullsisë, të pronës dhe të trashëgimisë kulturore nga fatkeqësitë natyrore-emergjencat e ndryshme.

Është e rëndësishme të theksohet se POE për MSHN nga FN & FT -a është një burim praktik i përdorshëm për të gjitha fazat e ciklit të fatkeqësive natyrore-emergjencave tjera, duke filluar nga parapërgatitja, përgjigjja dhe duke vazhduar më tej në fazën e rikthimit në gjendjen normale dhe lehtësimin e pasojave. Ky plan mbulon fazën e përgjigjes ndaj fatkeqësive natyrore-emergjencave tjera, mund të shkëputet përkohësisht për t'u mbajtur më vete gjatë periudhës së emergjencës, për të shërbyer si mjet praktik për bashkërendimin e aktiviteteve në përgjigje të situatës në terren.

Për arsye se ky plan është hartuar në bashkëpunim me protagonistët pjesëmarrës, ai është pronë e të gjitha drejtorive dhe autoriteteve në rangë të komunës, e të gjitha organizatave shtetërore dhe të shoqërisë civile (OJQ-ve), institucioneve, organizatave vullnetare dhe e publikut të gjerë.

Ky është dokument, i cili reflekton përvojën për një sërë dukurish të mundshme rreziku, kapacitetet dhe vështirësitë në përballimin e emergjencave të ndryshme në komunë.

POE për MSHN nga FN & FT-a shërben si burim i gjallë, real, një manual ku përmbledhen informacione, në të cilat janë përshkruar faktorët më të rëndësishëm dhe rolet e të gjitha institucioneve dhe të strukturave të përfshira në të gjitha fazat e menaxhimit të emergjencave. POE MSHN nga FN & FT -a nuk do të jetë asnjëherë plotësisht i përfunduar ose i mbyllur. Ai duhet të rishikohet e të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, duke reflektuar bashkëpunimin e përhershëm dhe ndryshimet në nevoja dhe burime të komunës.

Fuqia e POE MSHN nga FN & FT-a qëndron në bashkëpunimin dhe konsensusin e të gjitha institucioneve dhe strukturave, për të zvogëluar rreziqet, për të shpëtuar jetë njerëzore dhe për të minimizuar dëmtimet që vijnë si rrjedhojë e emergjencave në komunë.

Komuna e Gjilanit është mjaft e eksponuar përballë një numri të konsiderueshëm fatkeqësish natyrore dhe fatkeqësish që mund të vijnë nga veprimtaria njerëzore.

Rreziku më i madh nga fatkeqësitë natyrore mund të vijë nga tërmetet, por kohëve të fundit kanë qenë mjaft evidente edhe rrëshqitjet-erozionet e tokës, përmytjet apo emergjencat dimërore, edhe pse të shkallëve të vogla. Nisur nga gjendja ekonomike, infrastruktura, mjetet e pakta të komunikimit, emigrimi masiv, bumi i ndërtimeve si dhe një numër faktorësh që lidhen me shfrytëzimin pa kriter të burimeve natyrore, si: pyjeve, burimeve ujore dhe ndotja e mjedisit, e bëjnë më të prekshme popullsinë dhe ekonomin e saj ndaj këtyre dukurive.

Për të identifikuar rreziqet, si dhe për të pasur informacion për humbjet dhe dëmet e pritshme gjatë vitit 2003 e për të vazhduar deri në vitin 2012 edhe kur aprovohet në Kuvendin Komunal të Gjilanit, me që rast fuqizohet për herë të parë vlerësimi i rreziqeve në nivel komunal.

Ky studim ka harmonizuar rezultatet dhe gjetjet nga mbledhja e të dhënave, përpunimi dhe analiza e bërë gjatë disa viteve pune. Vlerësimi i rreziqeve përmban seksione të përqendruara në rreziqe të veçanta për dukurit e mundshme të rrezikut, si: tërmetet, përmytjet, bllokimi nga bora, erozioni-rrëshqitjet e tokës, zjarret në pyje dhe sëmundjet e ndryshme infektive siç janë: PLANI i veprimit kundër rriqrave i hartuar në janar 2009, PLANI i veprimit kundër gripit të derrave AH1N1 për Komunën e Gjilanit i hartuar në qershor 2009, si dhe PLANI i veprimit kundër Pandemisë së Virusit Covid 19, i vitit 2020.

Vlerësimi i rrezikut është një hap mjaft i rëndësishëm përpara dhe shërben si bazë në procesin e hartimit të POE për MSHN nga FN & FT -a, duke siguruar bazën informative në të cilën mund të hartohet një plan efektiv. Synimi kryesor është të jap drejtimet bazë për planifikim, mbi bazën e të dhënave të cilat mund të ngrihen skenar të ndryshëm për përballimin e emergjencave si dhe për të pasur informacion për dëmet e mundshme. Njëkohësisht ky plan pasqyron kapacitetet dhe mundësit që ka komuniteti për të zvogëluar rrezikun dhe për të përballuar emergjencat e mundshme, si dhe jep të dhëna të cilat duhen mbajtur në konsideratë gjatë planifikimit në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar.

Procesi i hartimit të POE për MSHN nga FN & FT-a

Ky proces është ndërmarr duke iu referuar bazës ligjore përkatësisht: Ligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera Nr. 04/-L-027, nenit 37 pika 1,2 dhe 3. dhe Rregullores me Nr. 08/2013 për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent.

Institucionet dhe strukturat e ndryshme komunale, në aktivitetin e tyre të përditshëm, funksionojnë në bazën e akteve ligjore, shumë prej të cilave, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, prekin probleme që kanë të bëjnë me fatkeqësitë-emergjencat. Për këtë arsye POE për MSHN nga FN & FT -a është i referuar dhe ka marr shumë nga ato, për të qenë i bazuar dhe i zbatueshëm.

Kjo është bërë për t'i dhënë hapësirë ligjore zbatimit të këtij plani, duke i krijuar mundësinë strukturave shtetërore dhe jo shtetërore për të vepruar në mënyrë efektive dhe për t'u përmbajtur detyrimeve ligjore në lidhje me emergjencat civile.

Vërehet gjithashtu, se për zbatimin sa më korrekt të këtij plani dhe për ushtrim të kompetencave të strukturave të përfshira, në disa drejtime ose sektorë të veçantë lind nevoja e akteve tjera ligjore e nënligjore, veçanërisht për aspektin e parandalimit të fatkeqësive-emergjencave, ku vlen të theksohet rëndësia që kanë përpjekjet e strukturave për t'i zbatuar ato.

Plani aktual i përgjegjësisë emergjente i komunës së Gjilanit është bazuar kryesisht në parimet e planit dhe në vlerësimin e rrezikut.

I. Qëllimi, Fushëveprimi, Situata dhe Supozimet

1.1 Qëllimi

Qëllimi i planit operativ emergjent në Komunën e Gjilanit është që të ketë koordinim të Institucioneve dhe strukturave të ndryshme relevante të forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, organizatave të ndryshme, shërbimeve emergjente (FSK, PK, shërbimeve emergjente mjekësore spitalore dhe para spitalore të Kosovës, shërbimet komunale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, shërbimet emergjente mjekësore komunale) dhe OJQ-të e ndryshme, aftësinë e veprimit sa më të shpejtë dhe të efektshëm në raste të ndryshme emergjente në Komunën e Gjilanit.

1.2 Fushëveprimi

Ky plan, së bashku me të gjitha referencat, shtojcat dhe anekset synon të përcaktoj se kush bënë çfarë, kur, ku dhe si, me qëllim të zbutjes, përgatitjes, reagimit dhe rimëkëmbjes nga efektet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

1.3 Situata

Komuna e Gjilanit përfshin një sipërfaqe prej 391 kilometra katrorë. Sipas Statutit të Komunës së Gjilanit, nenit 11, pika 2, territori i komunës si njësi territoriale përbëhet prej lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanime sipas zonave kadastrale si në vijim: Bilincë, Bresalc, Bukovik-Capar, Burincë, Cërnice, Çelik, Dobërqan, Dunav, Gadish, Goden i Vogël, Gjilan, Inatoc, Kishnapole, Kmetoc, Kravaricë, Uglar, Livoq i Epërm, Livoq i Ulët, Lipovicë, Llovcë, Lladovë, Llashticë, Malishevë, Muçibabë, Nasalë, Pidiq, Pogradje, Ponesh, Përlepnice Velekincë, Vrapçiq, Vërbicë, Vërbicë e Zhegocit, Sllubicë, Stançiq, Stublinë, Shillovë, Sllakoc i Epërm, Sllakoc i Ulët, Shurdhan, Zhegër, Zhegoc.

Qyteti i Gjilanit shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës, në rajonin e Anamoravës dhe kufizohet:

- në juglindje me Preshevën (33 km) dhe Kumanovën (malet e Karadakut,
- në lindje me Bujanocin (40.5 km),
- në verilindje me Kamenicën (29 km),
- në jug me Vitinë (20 km),
- në perëndim me Lipjanin dhe Prishtinën (47 km), dhe
- në verilindje me Novobërdën (19.5 km).

Në juglindje ka malet e Karadakut si dhe një pjesë të rrafshit të Kosovës - një fushë pjellore.

Rrethinën e Gjilanit e përshkon lumi "Morava e Binçës".

Nga kryeqyteti ka 47 km.

Mirëpo Gjilani njihet edhe si qendra e trekëndëshit të dyfishtë me të cilët trekëndësh lidhet me shtetet fqinjë, nga kjo shihet se ka një pozitë të volitshme gjeostrategjike.

Komuna e Gjilanit i ekspozohet shumë rreziqeve, të cilët kanë potencial eventual të çrregullimit të jetës normale të komunitetit dhe të shkaktojnë dëme dhe lëndime. Të gjitha fatkeqësitë natyrore - emergjencat mund të ndahen në: tërmete, vërshime,

rrëshqitjet e dheut, bora e madhe - ortekët, erërat e forta, breshëri, thatësira, paraqitja masive e sëmundjeve ngjithëse të njerëzimit, të shtazëve dhe të bimëve dhe fatkeqësi të tjera që i shkakton natyra.

Mirëpo nuk mund të përjashtohen edhe incidentet e sigurisë kombëtare, si për shembull aktet terroriste, apo edhe ato të materieve të rrezikshme, aksidentet teknologjike, aksidentet e mëdha të transportit, trazirat civile apo zjarret e mëdha.

Komuna e Gjilanit me kapacitetet e saja aktuale (edhe pse konsiderohet se nuk ka kapacitete të konsiderueshme) të cilat nëse përdoren me efikasitet në rast të fatkeqësive të ndryshme, do të ketë ndikim në ruajtjen e jetës, të mirave materiale dhe ambientit për komunitetin.

Në këto kapacitete përfshihen: resurset humane (fuqinë punëtore), resurset teknike (pajisjet e ndryshme të xhenios e tjera), aftësitë e agjencive qeveritare dhe atyre joqeveritare, profesionistët dhe ekipet e specializuara mjekësore, veterinare etj, sikur edhe njohurit e përgjithshme të komunitetit në përballimin e fatkeqësive (ndihma laike).

Objektiv i këtij plani është të sigurohet shfrytëzimi efektiv i këtyre aseteve nëse komunën e Gjilanit e godet çfarëdo lloj fatkeqësie.

1.4 Supozimet

Gati se është e pamundur parashikimi dhe efektet specifike të një fatkeqësie në Komunën e Gjilanit, apo gjasat se rreziku i caktuar do të ndodhë apo nuk do të ndodhë Sido që të jetë, komuna do të jetë subjekt i një numri të ndryshëm të situatave emergjente.

Në çfarëdo rrethane, obligimi për mbështetjen e ndërmarrjes së hapave të nevojshme për zvogëlimin e efektit të fatkeqësive ndaj komunitetit i bie qeverisë komunale.

Mirëpo në rastet kur e kemi një komunitet sado pak të përgatitur dhe i cili i ka ndërmarrë masat e duhura parandaluese kundrejt fatkeqësive të ndryshme, atëherë mund të ndikohet në humbjen e jetës së njerëzve dhe zvogëlimin e dëmeve eventuale sikur në infrastrukturë publike ashtu edhe në ekonomitë familjare.

Në raste të ndodhjes së Fatkeqësive Natyrore dhe Fatkeqësive Tjera, kapacitetet aktuale të agjencioneve (strukturave) emergjente të nivelit lokale janë të mjaftueshme për tu përball me situatën e krijuar deri në një masë të caktuar, por në rast të ndodhjes së një emergjence të sigurisë kombëtare, kapacitetet tona do të mbingarkohen maksimalisht ashtu që do të jetë patjetër e nevojshme ndihma nga qeveria qendrore (ashtu siç është e përcaktuar edhe në Planin e Reagimit Kombëtar) dhe sipas kompetencës së sajë ndihmat edhe nga jashtë.

Komuna e Gjilanit do të jetë e ekspozuar ndaj rreziqeve të përmendura më sipër sikurse edhe ndaj rreziqeve të tjera që mund të zhvillohen në të ardhmen. Përmasat e të lënduarve dhe dëmeve do të varen nga faktorët e tillë si, nëse ngjarja është parashikuar, koha në dispozicion për paralajmërim, momenti i ndodhjes, ashpërsia e goditjes, kushtet atmosferike, dendësia e popullatës dhe lloji i infrastrukturës së prekur, si dhe mundësia e nxitjes së ngjarjeve dytësore.

Ruajtja e jetës do të ketë prioritet mbi ruajtjen e të mirave materiale dhe mjedisit. Siguria e qytetarëve dhe personelit organeve të komunës, entiteteve mbështetëse dhe vullnetarëve do të jetë çështje parësore.

Zyrtarët e qeverisjes lokale i pranojnë përgjegjësitë lidhur me sigurinë dhe mirëqenien publike. ata do t'i marrin përsipër përgjegjësitë e tyre të zakonshme në zbatimin e planit të menaxhimit emergjent ose në detyrat tjera të caktuara apo të nevojshme.

Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave (SIME) është integruar në këtë plan dhe përdorimi i Sistemit të Komandës së Incidentit (SKI) është parimi bazë i procesit të menaxhimit emergjent. Të gjitha entitetet e komunës do të zbatojnë strukturë të unifikuar të SKI-së, ashtu siç kërkon SIME për aktivitetet në vendngjarje, gjatë operacioneve të reagimit, rimëkëmbjes dhe zbutjes.

Komuna e Gjilanit dhe entitetet në kuadër të saj do të përpiqen të kenë kapacitet të mjaftueshëm për të operuar për së paku 72 orë pa ndihmë nga jashtë dhe do të rekomandojnë që të gjithë qytetarët të kenë së paku kapacitet qëndrueshmërie për 96 orë.

II. KONCEPTI I VEPRIMIT/OPERIMIT

2.1 I përgjithshëm

Sipas strukturës së Sistemit të Komandës së Incidentit (SKI), në rrafshin lokal është përgjegjësi e qeverisjes lokale të Komunës së Gjilanit që të ndërmarr menaxhim emergjent gjithëpërfshirës me qëllim të mbrojtjes së jetës dhe të mirave materiale nga efektet e ngjarjeve të rrezikshme. Qeverisja lokale ka përgjegjësinë parësore për aktivitetet emergjente. Kur emergjenca tejkalon kapacitetin e qeverisjes lokale, të plotësuar normalisht nga ndihma reciproke, do të kërkohet ndihmë nga qeveria qendrore. Ndihma qendrore do të ofrohet me kërkesën e Kryetarit të Komunës.

Plani është i bazuar mbi konceptin që para reagimit të ndihmës së jashtme do të angazhohen të gjitha resurset lokale në emergjencë. Po ashtu është i bazuar në filozofinë që funksionet emergjente për grupet e ndryshme të përfshira në menaxhimin emergjent do të shkojnë paralel me funksionet e tyre të zakonshme. I njëjti personel do të angazhohet në të dyja rastet deri në masën më të madhe të mundshme. Megjithatë, do të ketë raste kur personelit do t'i duhet të punoj edhe jashtë funksioneve të tyre të zakonshme.

Funksionet e përditshme që nuk kontribuojnë drejtpërdrejt në operacionet emergjente mund të pezullohen ose reduktohen për kohëzgjatjen e emergjencës. Kjo do të kërkojë adresimin e këtyre aktiviteteve me mandat konstitucional. angazhimet që normalisht kërkohen për këto funksione do të ridrejtohen për përmbushjen e detyrave emergjente nga entiteti në fjalë.

Plani i menaxhimit gjithëpërfshirës emergjent ka të bëjë me të gjitha llojet e situatave të rrezikshme që mund të zhvillohen në Komunën e Gjilanit është më shumë se një plan operativ për faktin se llogarit në aktivitetet para, gjatë dhe pas një operacioni emergjent.

2.2 Fazat e menaxhimit

Zbutja: Aktivitetet e zbutjes janë ato aktivitete të cilat eliminojnë ose zvogëlojnë gjasën e ndodhjes së fatkeqësisë. Përveç këtyre aktiviteteve përfshijnë edhe aktivitetet afatgjata që pakësojnë efektet e padëshirueshme të rreziqeve të paevitueshme.

Gatishmëria: Aktivitetet e gatishmërisë i zhvillojnë kapacitetet e nevojshme për reagim ndaj emergjencave apo fatkeqësive. Planifikimi dhe trajnimet janë midis aktiviteteve të zhvilluara në këtë fazë.

Reagimi: Reagimi është ofrimi aktual i shërbimeve emergjente gjatë krizës. Këto aktivitete ndihmojnë zvogëlimin e të lënduarve dhe dëmeve, si dhe përshpejtojnë fazën e rimëkëmbjes. Aktivitetet e reagimit përfshijnë paralajmërimin, evakuimin, shpëtimin dhe operacionet tjera të ngjashme.

Rimëkëmbja: Rimëkëmbja është proces afatshkurtër dhe afatgjatë. Operacionet afatshkurta rikthejnë shërbimet jetike për komunitetin dhe plotësojnë nevojat elementare të popullatës. Rimëkëmbja afatgjate përqendrohet në rikthimin e komunitetit në gjendje normale apo të përmirësuar. Periudha e rimëkëmbjes është

po ashtu një mundësi e mirë për institucionalizimin e masave të zbutjes, veçanërisht ato që lidhen me emergjencën e fundit. Shembujt e veprimeve të rimëkëmbjes do të ishin sigurimi ushqimit dhe strehimit të përkohshëm, rikthimi i shërbimeve jetike qeveritare dhe rindërtimi i zonave të dëmtuara.

III. Organizimi dhe Caktimi i Përgjegjësive

3.1 I përgjithshëm

Pjesa më e madhe e drejtorive në qeverinë lokale kanë funksione emergjente në plotësim të detyrave të tyre të zakonshme. Secila drejtori/entitet është përgjegjëse për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e procedurave të saj të menaxhimit emergjent, subjekt i miratimit nga drejtoria komunale e menaxhimit emergjent. Përgjegjësitë specifike për fatkeqësitë e mëdha në tërë territorin e Komunës së Gjilanit janë të përvijuar më poshtë në paragrafin Caktimi i Detyrave, si dhe në anekset veç e veç (jo të përfshira në këtë plan bazik). Po ashtu janë të paraqitura edhe përgjegjësitë për organizatat e caktuara që nuk janë pjesë e qeverisë lokale. Jo të gjithë anëtarët e të gjitha grupeve do të paraqiten në të gjitha situatat.

Ky seksion ofron një pasqyrë të funksioneve dhe procedurave kryesore që do t'i përmbushin gjatë një emergjence agjencitë lokale apo regjionale, duke i përfshirë rolet që do t'i marrin agjencitë lokale, regjionale, qendrore dhe të sektorit privat për mbështetjen e operacioneve lokale.

Për aktivizimin e marrëveshjeve të ndihmës reciproke për shkëmbimin e resurseve gjatë një emergjence (Shih pikën 1.3 të planit bazik). Po ashtu lidhjet me Qendrën Operative Emergjente Regjionale 112 gjatë një emergjence do të adresohen në Aneksin e memorandumeve.

3.2 Organizimi

Qendra Operative Emergjente (QOE) e komunës e ndodhur në objektin e komunës në Rr: "Bulevardi i Pavarësisë" p.n, përkatësisht në objektin e zyrës së kryetarit të komunës, kati i dytë-zyra e drejtorit të DMSH-së do të funksionoj si Sistem i Koordinimit Ndërinstitucional (SKNI) për të gjitha emergjencat dhe fatkeqësitë që godasin Komunën e Gjilanit. QOE do të funksionoj sipas përkufizimit të SKNI-së në SIME. Përgjegjësia kryesore e QOE-së është të siguroj që të mirëmbahet kapaciteti për të reaguar ndaj emergjencave dhe fatkeqësive të paparashikuara që nuk kanë ndodhur ende në komunën tonë.

3.2.1 Grupi i politikave

Grupi i politikave i Komunës së Gjilanit është përgjegjës për të gjitha vendimet politike që kanë të bëjnë me menaxhimin emergjent, përfshirë delegimet e autoritetet dhe do të veprojnë si udhëheqësi ekzekutiv e reagimit të Komunës së Gjilanit. Anëtarët e përhershëm të këtij grupi janë:

- Kryetari i Komunës;
- Nënkryetari i Komunës;
- Shefi i zyrës ligjore;
- Zyrtari për Informim Publik (ZIP);
- Komandanti i Stacionit të Policisë së Kosovës;
- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim;
- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme;

- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- Drejtoria e Arsimit;
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim;
- Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë;
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë;
- Zyrtari për Informim Publik (ZIP);
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe
- Sekretari i Degës së Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Gjilan.

3.2.2 Grupi koordinues

Grupi koordinues i menaxhimit emergjent do të siguroj që politikat emergjente, aktivitetet mbështetëse dhe resurset janë të koordinuara midis spektrit të entiteteve pjesëmarrëse. Ky grup do të përgatisë kërkesat për ndihmë nga jashtë përtej asaj që ofrohet përmes ndihmës reciproke. Ata do të jenë të organizuar për t'i përmbush përgjegjësitë e jashtë vendit të incidentit, pra të planifikimit, logjistikës dhe financave me shefat e sektorëve, drejtorët e degëve dhe udhëheqësit e njërive të caktuar nga anëtarësia.

Anëtarët e grupit koordinues të menaxhimit emergjent janë kruesisht zv.drejtor; zv.komandant;shefa sektori apo përfaqësues të agjencive pjesmarrës në emergjencë.

Organizimi i funksioneve nënkupton që grupi koordinues do t'i përmbush funksionet e sektorëve të logjistikës, financave dhe planifikimit dhe grupi operativ do ta përmbush funksionin e Sektorit të Operativës sipas Sistemit të Komandës së Incidentit (SKI).

3.2.3 Sektori Operativ i Menaxhimit Emergjent

Sektori operativ i menaxhimit emergjent do të siguroj zbatimin e politikave dhe aktivitetëve sipas vendimeve të grupit të politikave dhe udhëzimeve të grupit koordinues. Përgjegjësia parësore e grupit operativ është koordinimi i dislokimit të resurseve përkatëse për ta tejkaluar dhe zvogëluar efektin e emergjencave të mëdha. Ata do të jenë të organizuar për të ofruar mbështetje të drejtpërdrejt për Komandantët e Incidenteve ndërkohë që ofrojnë shërbime për tërë komunitetin sipas urdhrave të grupit të politikave që operon nga QOE. Në anëtarët e sektorit të operativës përfshihen zyrtarët operativ, personeli mbështetës dhe ndërlidhësit e entiteteve. Në anëtarësinë e sektorit operativ të menaxhimit emergjent përfshihen të gjithë përfaqësuesit e entiteteve të renditura në grupin koordinues plus përfaqësues tjerë të fushave të veçanta sipas nevojës së ngjarjes.

3.3 Caktimi i përgjegjësi (jo shtruese)

➤ Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH)

1. Koordinimi i të gjitha fazave të menaxhimit emergjent
2. Planifikimi gjithëpërfshirës i menaxhimit emergjent
3. Trajnimi i stafit dhe reaguesve
4. Menaxhimi i resurseve (si: mbikëqyrja e resurseve të juridiksionit, kërkesat për resurse nga jashtë, përfshirë ndihmën qendrore, ndihmën reciproke)
5. Komunikimi dhe paralajmërimi
6. Trajnimet dhe ushtrimet për materie të rrezikshme
7. Mbështetja e komiteti lokal të planifikimi emergjent
8. Menaxhimi i stërvitjeve dhe ushtrimeve
9. Vlerësimi i gatishmërisë së komunitetit
10. Hartimi i planit operativ emergjent (POE)
11. Shpërndarja e informatave emergjente
12. Vendosja e ndërlidhësit me entitetet qendrore
13. Menaxhimi i shpenzimeve financiare të fatkeqësisë
14. Koordinimi i aktivizimit të reagimit të juridiksionit
15. Koordinimi i aktivizimit dhe ndarjes së rezervave të medikamenteve,
16. Koordinimi i vlerësimit të dëmeve,
17. Koordinimi i zhvendosjes në krizë,
18. Caktimi i Kryqit të Kuq të Kosovës Koordinator

Përmes Sektorit të Mbrojtjes dhe Shpëtimit siguron:

1. Kontrolli i zjarreve të gjitha llojeve,
2. Inspektimi i parandalimit të zjarreve,
3. Operimi me njësitë fikse dhe mobile të sirenave,
4. Operacionet e kërkimit dhe shpëtimit,
5. Vlerësimi i dëmeve,
6. Operacionet e materieve të rrezikshme,
7. Shpëtimi në miniera,
8. Mbështetja e komunikimit,
9. Kërkimi dhe shpëtimi urban,
10. Asistimi i QIP në shpërndarjen e informacion publik emergjent
11. Monitorimin dhe raporton dëmet nga tërmeti,
12. Kontrollin i zjarreve,
13. Asistimi i zbatuesve të ligjit (PK) në kontrollin e trafikut,
14. Koordinimi i operacioneve në vendngjarje të incidenteve me materie të rrezikshme.

➤ **Zbatimi i Ligjit - Policia e Kosovës (PK)**

1. Mbajtja e rendit dhe qetësisë publike,
2. Kontrolli i trafikut (përfshirë monitorimin e rrjedhës së trafikut, zbatimin e kufizimit të qarkullimit),
3. Kontrolli i zonave të kufizuara (hyrjet dhe daljet),
4. Ruajtja e objekteve jetike (strukturat fizike dhe caqet e buta),
5. Sigurimi i çdo vendi apo objekti të operimit fushor,
6. Mbështetja e vlerësimit të dëmeve,
7. Ndërlidhja dhe koordinimi me zbatuesit tjerë të ligjit,
8. Kërkimi dhe shpëtimi i lehtë,
9. Koordinimi me Forcën e Sigurisë së Kosovës lidhur me çështjet e sigurisë,
10. Identifikimi i fataliteteve,
11. Mbështetja e shpëtimit ajror,
12. Mbështetja e shpëtimit mjekësor,
13. Mbështetja e grupeve të politikave, koordinimit dhe operacioneve,
14. Këshillimi i grupit të politikave lidhur me anulimin e ngjarjeve, kufizimet, etj,
15. Menaxhimi i rikthimit,
16. Asistimi i Qendrës së Informimit të Përbashkët (QIP) me shpërndarjen e informacionit publik emergjent.

➤ **Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS)**

1. Hetimi i kushteve sanitare,
2. Inspektimi i furnizimeve të ushqimit dhe ujit (dhe strehimoreve emergjente),
3. Ofrimi i edukimit dhe informimit publik mjekësor,
4. Këshillimi i grupit të politikave lidhur me çështjet e shëndetit publik,
5. Mbikëqyrja e shërbimit mjekësor emergjent,
6. Shërbimi si ndërlidhës me komunitetin mjekësor përfshirë (Qendrën për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve) gjatë fatkeqësive të mëdha apo emergjencave që rezultojnë me të lënduar,
7. Asistimi në përvetësimin e personelit mjekësor për plotësimin e objekteve alternative të kujdesit mjekësor,
8. Zbatimi i aktiviteteve të zbulimit dhe detektimit të agentëve biologjik,
9. Ofrimi i mbështetjes së testimeve laboratorike dhe hetimet epidemiologjike,
10. Monitorimi dhe menaxhimi i depove farmaceutike lokale,
11. Kërkimi dhe përvetësimi i Rezervave Strategjike Kombëtare,
12. Këshillimi lidhur me sigurimin e protokolleve shëndetësore/mjekësore dhe të trajtimit për sëmundjet/agjentët,
13. Këshillimi lidhur me vendimet për izolim/karantinë,
14. Ndërveprimi me zbatimin e ligjit për të asistuar në masat e vendit të krimit (si: ruajtja e provave, zinxhiri i ruajtjes së provave, hetimi i vendit të krimit),
15. Çështjet veterinerë/ zoonotike,
16. Testimi dhe rehabilitimi mjedisor,
17. Ofrimi i menaxhimit të stresit të incidenteve kritike,

18. Mobilizimi për trajtimin e të lënduarve,
19. Tirazhi, trajtimi, dhe transportimi i të lënduarve,
20. Vazhdimi i mbulimit të zonave të paprekura,
21. Koordinimi i evakuimeve me helikopter,
22. Menaxhimi i depove të pajisjeve mjekësore për të lënduarit në masë,
23. Menaxhimi i transferimit midis objekte/shërbimeve,
24. Ofrimi i shërbimeve shtesë sipas drejtimit të drejtorit të drejtorisë së shëndetësisë,
25. Asistimi i QIP në shpërndarjen e informacionit publik emergjent,
26. Këshillimi lidhur me çështjet që lidhen me spitalin,
27. Koordinimi i planeve të spitalit,
28. Ofrimi i kujdesit për pacient në masë,
29. Menaxhimi i programit të shtretërve të spitalit,
30. Monitorimi dhe raportimi për pacientët,
31. Monitorimi dhe raportimi lidhur me nevojat për furnizime dhe personel,
32. Përcjellja dhe koordinimi i pacientëve dhe
33. Koordinimi i bartjes së mëtejshme nga objekti.

➤ **Drejtoria e Shërbimeve Publike**

1. Mirëmbajtja e sistemit të ujit të pijes dhe ujërave të zeza,
2. Mirëmbajtja e operacioneve të largimit të rrënojave dhe hedhjes së mbeturinave,
3. Riparimet e urave dhe rrugëve,
4. Deponimi i karburanteve,
5. Sigurimi i personelit, pajisjeve, furnizimeve dhe resurseve tjera (të specializuar) sipas nevojës,
6. Mirëmbajtja e presionit të ujit,
7. Mbështetja e vlerësimit të dëmeve,
8. Sigurimi i ujit të pijshëm,
9. Koordinimi me drejtorinë e shëndetësisë për testimin e ujit,
10. Mbështetja e personelit të grupit të politikave dhe grupit koordinues,
11. Mbështetja e kërkimit dhe shpëtimit,
12. Inspektimi i ndërtesave, sipas nevojës,
13. Mbështetja e kontrollit të trafikut (dhe hapja e rrugëve të përkohshme për qasje emergjente),
14. Riparimi i objekte jetike,
15. Pastrimi i rrënojave,
16. Sigurimi i këshillave dhe shërbimeve emergjente inxhinierike,
17. Kontrolli i vërshimeve dhe
18. Mbështetja e vlerësimit të dëmeve.

➤ **Drejtoria për Buxhet dheFinanca**

1. Mirëmbajtja e shënimeve/të dhënave,
2. Blerja e furnizimeve,
3. Mbështetja e grupit koordinues me personel,
4. Përgatitja për kërkesat për rimbursim,
5. Përpunimi i pjesës financiare të vlerësimit të dëmeve dhe
6. Përpunimi i kompensimeve të stafit dhe të lënduarve.

➤ **Drejtoria e arsimit**

1. Mbrojtja e fëmijëve në shkollë,
2. Sigurimi i strehimit publik,
3. Sigurimi i objekteve të shkollës,
4. Koordinimi i ribashkimit nxënës-familje,
5. Sigurimi i hapësirës për vaksinim në masë,
6. Sigurimi i edukimit publik lidhur me menaxhimin emergjent,
7. Sigurimi i mjeteve të transportit për transportim dhe
8. Mobilizimi i personelit të shkollave për mbështetjen e operacioneve të menaxhimit emergjent të strehimoreve.

➤ **Zyra e mjekut ligjor**

1. Grumbullimi, identifikimi dhe varrimi i të vdekurve,
2. Ruajtja e provave dhe zinxhirit të ruajtjes së provave për mbështetjen e operacioneve të zbatimit të ligjit dhe
3. Koordinimi me shërbimet tjera, përfshirë kompanitë për funerale dhe autoritetet qendrore.

➤ **Prokurori**

1. Mbështetja me këshilla ligjore,
2. Mbështetja e grupit të politikave dhe
3. Përgatitja e dekreteve dhe urdhrave

➤ **Kryqi i Kuq i Kosovës dega në Gjilan**

1. Operacionet e kujdesit masiv të strehimit,
2. Ushqyerja në masë (vendet fikse dhe mobile),
3. Ndihma personale/familjare,
4. Mbështetje të edukimit publik dhe informimit,
5. Mbështetje në ndihmë të parë dhe
6. Mbështetje konsulente.

➤ **Kompania e telefonisë**

1. Ofrimi i këshillave lidhur me operimin dhe mirëmbajtjen e telefonisë,
2. Kontrolli i linjave tokësore,
3. Ofrimi i ndihmës në komunikim për entitetet kërkuese sipas nevojës,
4. Koordinimi i aktiviteteve të planifikimit të komunikimit me QOE,
5. Vlerësimi i dëmeve në infrastrukturën e telekomunikimit celular dhe komunikimi i të gjeturave në QOE dhe
6. Koordinimi dhe bërja e riparimeve sipas nevojës.

➤ **Teknmologjia informative**

1. Koordinimi i vlerësimit të integritetit të sistemit të telekomunikimit gjatë dhe pas emergjencës apo fatkeqësisë,
2. Vendosja e protokollit të komunikimit emergjent, duke përfshirë caktimin apo ricaktimin e pajisjeve ekzistuese të komunikimit,
3. Krijimi i kapacitetit të komunikimit me telefon dhe intra/internetit midis entiteteve të reagimit emergjent,
4. Operimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të telekomunikimit,
5. Ofrimi i asistencës mbështetëse brenda kapacitetit teknik (Shënim: Përgjegjësia për të gjitha sistemet unike të telekomunikimit i bie entitetit nikoqir dhe
6. Sigurimi i kapacitetit të nevojshëm GIS.

➤ **KEDS**

1. Këshillimi në shpërndarje të energjisë elektrike,
2. Këshillimi lidhur me ndërprerjet e energjisë elektrike dhe parashikimet e efektit dhe
3. Vlerësimi i dëmeve dhe riparimi.

➤ **Mbështetja e Forcës së Sigurisë së Kosovës**

1. Mbështetje në paralajmërim,
2. Mbështetje në kontroll të trafikut,
3. Mbështetje në kërkim dhe shpëtim,
4. Mbështetje të shërbimeve mjekësore,
5. Mbështetje në largimin e rrënojave,
6. Mbështetje në kontrollin e zjarreve,
7. Mbështetje logjistike,
8. Mbështetje inxhinierike,
9. Mbështetje në strehim dhe
10. Mbështetje të komunikimit.

IV. Drejtimi dhe kontrolli

- A. Kryetari i Komunës së Gjilanit është përgjegjës për menaxhim emergjent brenda kufijve administrativ komunal,
- B. Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim i Komunës së Gjilanit nën mbikëqyrjen e kryetarit të Komunës do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të planifikimit dhe operacioneve emergjente në territorin e komunës së Gjilanit. Kjo do të përfshijë koordinimin ndërinstitucional apo ndër-sektorial si dhe koordinimin e grupeve, agjencive dhe organizatave qytetare në komunën e Gjilanit,
- C. Kryetari i Komunës dhe drejtori i DMSH janë përgjegjës për përcaktimin e nevojës për evakuim dhe kanë autoritetin e nxjerrjes së urdhrave për evakuim, të cilët do të zbatohen nga personeli i institucioneve të zbatimit të ligjit. Në rastet kur është i pashmangshëm kërcënimi i jetës dhe të mirave materiale, zbatuesit e ligjit apo sektori i zjarrfikës kanë autoritetin e fillimit të procedurave të evakuimit, ndërkohë që urdhri për evakuim kalon përmes kanalit përkatës,
- D. Njerëzit dhe entitetet specifike janë përgjegjës për përmbushjen e obligimeve të tyre ashtu siç janë paraqitur në planin bazik. Çdo entitet do t'i ndjek procedurat e veta të operimit gjatë operacioneve të reagimit. Të gjitha entitetet e Komunës së Gjilanit janë njoftuar për mundësinë e thirrjes së personelit të tyre për përmbushjen e misioneve të caktuara të menaxhimit emergjent, të tilla si kontrolli i thashethemeve/linjat e kuqe të informimit publik, etj.

V. Vijimësia e qeverisjes

Operacionet efektive gjithëpërfshirëse të gatishmërisë emergjente varen në dy faktor të rëndësishëm për të siguruar vijimësi të qeverisjes nga niveli më i lartë deri tek ai më ulët:

1. Radha e mandateve të zyrtarëve/drejtorëve të agjencive/personelit të autorizuar dhe
2. Ruajtja e të dhënave (dokumentet).

A. Radha e komandës- radha e qeverisjes së Qeverisë Lokale (komunale)

Meqenëse mungon infrastruktura ligjore në lidhje me vijimësinë e qeverisjes lokale, pasi që ligji mbi vetëqeverisje lokale nuk e ka përcaktuar se kush e ka mandatin për të vazhduar qeverisjen në mungesë të kryetarit të komunës, duhet që medoemos të përcaktohet me akte nënligjore të qeverisë komunale të përcaktohet hierarkia e qeverisjes sipas vendimit të kryetarit të komunës me numër _____ datë _____.

Secila drejtori, sipas procedurave standarde operative, cakton radhën e mandateve për secilin kryesues të drejtorisë së tij.

B. Ruajtja e të dhënave (dokumentet)

Niveli qendror

Çdo agjenci/drejtori është përgjegjëse për mbajtjen dhe regjistrimin e të gjitha dokumenteve juridike që kanë ndikim në organizimin dhe administrimin e funksioneve të gatishmërisë emergjente. Për më tepër, është përgjegjësi e zyrtarëve shtetëror që të kujdesen që të gjitha shënimet të jenë të sigurt dhe të mbrojtura nga elementet e dëmtimit apo shkatërrimit gjatë gjithë kohës.

Niveli lokal

Është përgjegjësi e Zyrës Ligjore të siguroj që të gjitha dokumentet juridike të të dyja natyrave, publike dhe private të regjistrohen nga zyrtari i caktuar, të jenë të mbrojtura dhe konservuara në pajtim me ligjin për ruajtjen e të dhënave. Shembujt përfshijnë dekretet, vendimet, procesverbalet e takimeve, tapitë e tokave dhe regjistrat e taksave.

VI. Administrata dhe logjistika

A. Autoriteti emergjent

Një përmbledhje e legjislacionit ekzistues që i përket gatishmërisë për fatkeqësi dhe reagimit ndaj tyre, si dhe menaxhimit emergjent është e pasqyruar në Pjesët 4, 5 dhe 6.

B. Procedurat e Shpalljes

1. Çdo emergjencë apo fatkeqësi mund t'i ngarkoj përpjekjet e reagimit dhe rimëkëmbjes përtej kapacitetit të Komunës së Gjilanit. Grupi i politikave, duke vepruar në emër të komunës, me deklarimin e gjendjes emergjente lokale, kërkon nga Kryetari i Komunës të kërkoj nga Kryetari i vendit shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme.
2. Nëse resurset e juridiksionit konsiderohen jo përkatëse për ta menaxhuar ngjarjen me efektivitet, kryetari i komunës mund të kërkoj nga Kryetari i vendit shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme. Procedurat për këtë janë të përshkruara në Planin e Reagimit Kombëtar, faqja 51.
3. Në rastet kur shihet qartë që dëmi është serioz dhe kërkon mbështetje të menjëhershme kryetari i komunës ka në dispozicion opsionin e dislokimit të menjëhershëm të ekipeve për vlerësimin e dëmeve.

C. Ndihma reciproke

Nëse resurset lokale konsiderohen jo përkatëse gjatë një operacioni emergjent, do të shtrohen kërkesa për ndihmë nga juridiksionet fqinje dhe niveli tjetër i qeverisjes, sipas marrëveshjeve ekzistuese për ndihmë reciproke dhe memorandumet e mirëkuptimit. Ndihma e tillë mund ta merr formën e pajisjeve, furnizimeve, personelit apo kapaciteteve tjera në dispozicion. Të gjitha marrëveshjet dhe memorandumet do të futen në fuqi nga zyrtarët e autorizuar dhe do të zyrtarizohen me shkrim kur të krijohet mundësia.

D. Mbrojtja e konsumatorit

Ankesat konsumatorëve që kanë të bëjnë me pretendimet për praktikat e padrejta apo të paligjshme do të referohen tek Drejtoria e Inspeksionit dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, me tendencë që konsumatori të mos dëmtohet dhe të mbrohet konform Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit Nr. 04/L-121. Procedurat e vendosura nga Komuna e Gjilanit për shkeljet e caktuara, si ngritja e çmimeve për shembull, janë të theksuara në Aneksin A: Informimi dhe Edukimi Publik.

VII. Operacionet e evakuimit

- A. Evakuimi i qytetarëve nga shtëpitë e tyre gjatë një emergjence kërkon përpjekje të koordinuar midis disa entiteteve të sigurisë publike. Duhet të merret vendim për dy opsione, ose të bëhet evakuimi fizik i njerëzve në vend të sigurt ose të strehohen në vendndodhje.
- B. Vendimi për evakuim mund të merret nga Komandanti i Incidentit kur përcaktohet rrezik i qartë dhe i menjëhershëm ndaj jetës apo shëndetit njerëzor (si p.sh. rrjedhje toksike kimike). Kur rreziku ndaj jetës ose shëndetit rritet ngadalë me kalimin e kohës (si p.sh. të reshurat e vazhdueshme të shiut me mundësinë e përfundimit në vërshime), vendimi për evakuim mund të merret pas deklarimit të gjendjes emergjente dhe duhet të urdhërohet nga autoriteti deklarues.
- C. Komandanti i Stacionit të Policisë së Kosovës në Komunën e Gjilanit ka përgjegjësinë dhe autoritetin parësor për zhvillimin e një evakuimi pasi të jetë drejtuar nga një Komandant Incidenti ose nga autoriteti që deklaroi emergjencën. Ndiham mund të ofrohet nga Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Shërbimet Publike, Forca e Sigurisë e Kosovës dhe entitetet tjera të linjës.
- D. Evakuimi i personave në rrezik të menjëhershëm konsiderohet i detyrueshëm kur urdhërohet nga autoriteti. Personat që e kundërshtojnë urdhrin legjitim për evakuim mund të arrestohen. Evakuimi si masë parandalimi konsiderohet vullnetar dhe personat që refuzojnë evakuimin mund të lehen në vendet e tyre në përgjegjësinë e tyre.
- E. Me pranimin e urdhrit për evakuimin e zonës së caktuar, zyrtarët policor së pari do ta vendosin perimetrin e sigurisë për ta parandaluar hyrjen në zonë dhe pastaj do të caktojnë shtigje të qarta dhe të detyrueshme për dalje nga zona e caktuar.

VIII. Qendra e informimit publik

- A. QOE e komunës do të ngritë QIP dhe qendrën për medie për të ofruar komunikata me kohë dhe të sakta për ta informuar publikun për fatkeqësinë apo emergjencën, duke e përdorur Sistemin e Informimit të Përbashkët (SIP). QIP parësor është e vendosur në objektin e QOE por jo brenda saj.
- B. ZIP i komunës (apo i caktuari) do të shërbejë si zëdhënës zyrtar për nxjerrjen e komunikatave për shtyp në emër të kryetarit të komunës. Këto komunikata do të shërbejnë si deklarata zyrtare të komunës. Kryetari i komunës dhe anëtarët e kuvendit të komunës, kryesuesi dhe anëtarët e bordit të drejtorëve po ashtu mund të bëjnë deklarata por të koordinuara nga ZIP.
- C. Informacionet inteligjente për fatkeqësinë apo emergjencën do të qarkullojnë nga QOE në QIP për grumbullim, verifikim dhe shpërndarje publike. Personeli i informimit publik i entiteteve të ndryshme mbështetëse do t'i plotësojnë pozitat operative të QIP. Informatat relative me çështjet e zbatimit të ligjit do të shqyrtohen me entitetin përkatës të zbatimit të ligjit para nxjerrjes në publik për sigurinë operative dhe integritetin hetimor. E njëjta gjë vlen edhe për ekspertët e disiplinave të ndryshme që e plotësojnë QIP (si p.sh. Shëndeti Publik).
- D. QIP i komunës do të koordinoj me ZIP/QIP për aktivitetet në juridiksionet përreth dhe me nivelin qendror. Strategjia kyçe është që çdo komponent do t'i adresoj çështjet vetëm brenda fushës së tij të përgjegjësisë.

VIII. Përfundimi i fatkeqësisë

- A. Pasi forcat në terren të kenë përcaktuar që reagimi emergjent nuk është më i nevojshëm për shpëtimin e jetës apo mbrojtjen e të mirave materiale dhe kur rimëkëmbja bëhet çështje parësore e nevojshme për riparimin e infrastrukturës dhe rikthimin e normalitetit në komunitet, fatkeqësia apo emergjenca do të përfundohet/anulohet (shih Shpalljen e Përfundimit). Kjo shpallje e përfundimit do të paraqitet para kuvendit të komunës për ratifikim, në takimin e radhës të rregullt të kuvendit.
- B. Me deklarin e emergjencës lokale për të cilën Kryetari i vendit shpall gjendjen e jashtëzakonshme, Grupi i Politikave i komunës do të përgatis dhe dorëzoj një raport pas veprimi tek Agjencia e Menaxhimit Emergjent pas përfundimit të periudhës së incidentit. Raporti pas veprimit më së paku duhet të jetë pasqyra e veprimeve reaguese, përshtatjeve të sugjeruara në plane dhe procedura, përcaktimit të nevojave për trajnime dhe aktiviteteve të rimëkëmbjes.

IX. Hartimi dhe mirëmbajtja e planit

- A. Për të qenë efektiv plani, përmëmbajtja e tij duhet të jetë e njohur dhe e kuptuar nga ata që janë përgjegjës për zbatimin tij. Drejtori i drejtorisë së menaxhimit emergjent dhe kryesuesit e entiteteve të përfshira do t'i njoftojnë zyrtarët përkatës të sektorit publik/privat për menaxhimin emergjent dhe këtë plan në veçanti. Do të ketë trajnime për tërë personelin e përfshirë çdo tremujor të vitit.
- B. Planit duhet të përditësohet së paku një herë në vit dhe të testohet me emergjencë të simuluar, pavarësisht ngjarjeve reale, me qëllim të ofrimit të përvojës praktike, të kontrolluar, operative për personat që kanë përgjegjësi emergjente.
- C. Entiteteve do tu caktohen përgjegjësi parësore për pjesën e tyre në plan. Listat e telefonave dhe informatat tjera për kontakt do të përditësohen çdo tre muaj me rishikimin e plot të planit çdo vit.

X. Skema organizative e qendrës operative emergjente të Komunës së Gjilanit

